



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:052927

Datë: 27.10.2022

Numri i dokumentit: 03574394

P.nr.1010/16

GJYKATA THEMLORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

- **Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me procesmbajtësin zyrtarin ligjor Gent Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurit N.N.nga Fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.nr.1109-6/2016 të datës 21.10.2016, duke vendosur në kuptim nenit 106 paragrafi 1 nën par 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së nenit 253 par.1 nën par.1.3 dhe nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPRK-së, me datën 27.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.nr.1109-6/2016 të datës 21.10.2016, kundër të pandehurit **N.N.** nga Fshati, Komuna Shtime, i lindur me date, nga i ati I..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, dhe **PUSHOHET** procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën par 1.6 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet gjyqësore dhe paushalli gjyqësor bien në barrë te mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka parashtruar aktakuzën, PP.II.nr.1109-6/2016 të datës 21.10.2016,, kundër të pandehurit N.N. nga Fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata ka caktuar seancën më dt. 20.12.2016 dhe palët ne procedurë i ka ftuar me ftesa të rregullta, dhe ka tentuar që ta siguroj të pandehurin por që i njëjti ka munguar, dhe ne fletë kthesën e datës 07.12.2016 është konstatuar se pala është i panjohur ne këtë adres, personi me emër dhe mbiemër i kërkuar nuk ka.

Gjykata edhe për datën 22.08.2017 ka caktuar por për të pandehurin dorëzuesi i ftesave me datën 21.07.2017 ka ndërmarrë veprime për dorëzimin e ftesës për datën e caktuar nga gjykata por marrësi është i pa njohur në fshatin, Komuna Shtime.

Gjykata me datën 22.08.2017 ka bere kërkesë për verifikimin e adresës së të pandehurit, Stacionit Policor ne Shtime, por gjykata nuk kishte pranuar njoftim dhe në vazhdim ka përsërit që të bëhet verifikim me datën 31.07.2018, ku ka pranuar, nga Polica e Kosovës-Drejtoria Rajonale e Policisë-Ferizaj Stacioni Policor Shtiem, Memorandumit zyrtar te datës 14.09.2018, me numër te referencës 04/1-05SH-..../2018, kane njoftuar gjykatën se në bazë të kërkesës me numër P.nr.1010/16 për të pandehurin N.I.N., i lindur me datën, me vendbanim në Fshatin - Komuna Shtime, Njësi duke vepruar sipas urdhëresës për verifikim kanë theksuar se nuk ka person i kërkuar me të dhënat e kërkuara, ku është bërë Verifikimi edhe në Qendrën e regjistrimit, mirëpo NUK është identifikuar ky person.

Nga dispozitivi i akuzës rezulton se vepra penale pretendohet të jetë kryer me datë 01.06.2016, ku për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së, sipas akuzës parashihet dënimi me burgim prej 3 muajve deri në 3 (tre) vjet.

Konform nenit 106 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së është paraparë se ndjekja penale për veprat penale të dënueshme më shumë se 1 (një) vjet burgim, nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tre) vjet nga kryerja e veprës penale, dhe nuk është ndërmarr ndonjë veprim procedural që do ta ndërprejë parashkrimin.

Me ç'rast është ndërprerë parashkrimi, por që nga këto data ka filluar të rrjedh rishtas afati i ri i parashkrimit, megjithatë që nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar mbi 6 vite, çka është edhe dyfishi i kohës së parashkrimit. Në kuptim të nenit 107 par.8 të KPRK-së ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, në rastin konkret nga 19 Maj 2016 kanë kaluar mbi 6 (gjashtë) vite që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Përfaqësuesi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari-Spektori i Pylltarisë në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par 1 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1010/16 më dt.27.10.2022

Zyrtari Ligjor
Gent Mustfa

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 5 ditësh , Gjykatës së Apelit në Prishtinë , nëpërmjet kësaj gjykate.